



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 58 të Ligjit Nr.04/ L-179 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës propozon :

Në mbështetje të neneve 12 dhe 34 të Ligjit Nr.03/ L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 4 par.1 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, si dhe nenit 14 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më _____miratoi këtë

PROJEKT

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN DHE BASHKËPUNIMIN E KOMUNËS ME FSHATRA, VENDBANIMET DHE LAGJET URBANE

I . DISPOZITAT E PËRGJITHËSHME

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Rregulloreje është të përcaktohen format e organizimit, funksionimit dhe bashkëpunimit ndërmjet Komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane të Komunës së Lipjanit në ushtrimin e disa aktiviteteve që janë në përgjegjësi dhe kompetencë të komunës.

Neni 2

Objekti i rregullimit

Objekt i rregullimit të kësaj rregulloreje janë format e bashkëpunimit ndërmjet Komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane urbane për çështje të interesit publik si dhe organizimi dhe funksionimi i këshillave lokale.

Neni 3

Përkufizimet

1.Shprehjet e përdorura në këtë Rregullore kanë kuptimin si në vijim:

- 1.1 **Këshillat lokale** – nënkupton trupat e zgjedhur që përfaqësojnë në mënyrë të organizuar komunitetin e një apo më shumë fshatrave , vendbanimeve apo lagjeve urbane.
- 1.2 **Kryetar i këshillit** – nënkupton personin më të votuar në tubim zgjedhor në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane.

II. BASHKËPUNIMI I KOMUNËS ME KËSHILLAT LOKALE

Neni 4

Bashkëpunimi i Komunës me këshilla lokale

1.Bashkëpunimi i Komunës me këshilla lokale bëhet për çështjet që janë në kompetencë të Komunës si:

- 1.1 Planifikimin urban dhe rural
- 1.2 Furnizimin me ujë, rregullimin e kanalizimit, drenazhimin
- 1.3 Shëndetësinë publike
- 1.4 Mbrojtjen lokale të ambientit
- 1.5 Turizmin
- 1.6 Hapësirat publike dhe varrezat
- 1.7 Aktivitetet kulturore dhe sportive etj.

Neni 5

Marrëveshjet për bashkëpunim

1.Komuna mund të lidhë marrëveshje me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane për përmbushjen e nevojave në zhvillimin ekonomik dhe të infrastrukturës, të arsimit, shëndetësisë dhe të ofrimit të shërbimeve nga kompetenca e Komunës, me interes për të gjithë qytetarët.

2. Inicitiva për lidhjen e marrëveshjeve mund të bëhet nga Kryetari dhe Kuvendi i Komunës, nga tubimet e qytetarëve dhe këshillat e vendbanimeve, fshatrave dhe lagjeve urbane.

3. Marrëveshja e bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane , duhet të përmbajë së paku këto elemente:

3.1 Objektin e Marrëveshjes;

3.2 Kohëzgjatjen;

3.3 Përshkrimin e obligimeve për palët;

3.4 Dinamikën e realizimit të punëve; dhe

3.5 Koston financiare

Neni 6

Miratimi i marrëveshjes së bashkëpunimit

Marrëveshjet të cilat i lidh Komuna me këshillat lokale miratohen nga Drejtorati përkatës në Komunë.

Neni 7

Konsultimet mes të komunës dhe këshillave lokale

1.Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Kryesuesin e Kuvendit organizojnë së paku dy takime në vit me Kryetarët e Këshillave lokale.

2. Kryetarët e këshillave lokale, ftohen të marrin pjesë në takime konsultative , debate publike dhe konsultime publike me qytetarë.

3.Kuvendi Komunal duhet të konsulotojë këshillin lokal, në çështje të caktuar me interes për komunitetin.

III. ORGANIZIMI I FSHATRAVE, VENDBANIMEVE DHE LAGJEVE URBANE

Neni 8

Fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane

Komuna e Lipjanit përbëhet nga qyteti i Lipjanit me 4 lagje urbane si dhe vendbanimet, fshatrat në pajtim me Statutin e Komunës.

Neni 9

Organizimi dhe funksionimi i këshillave lokale

Duke u bazuar në numrin e banorëve konform dispozitës së nenit 4 par. 2.5 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, Komuna e Lipjanit duhet të ketë njëzet e pesë (25) këshilla lokale.

Neni 10

Themelimi i komisionit të Kuvendit të Komunës për zgjedhjen e këshillave lokale

1.Me Vendim të Kuvendit të Komunës themelohet Komisioni për të koordinuar procesin e zgjedhjes së këshillave lokale.

1.1 Komisioni duhet të ketë shtatë (7) anëtarë . Përbërja e Komisionit duhet të jetë (4) anëtarë nga Kuvendi i Komunës nga subjektet e ndryshme politike, një (1) anëtar nga ekzekutivi, një (1) nga shoqëria civile dhe një (1) përfaqësues nga fshati, vendbanimi apo lagja urbane nga lokaliteti ku bëhet zgjedhja e këshillit lokal.

1.2 Komisioni do të reflektoj përfaqësimin gjinor dhe etnik.

1.3 Komisioni raporton para Kuvendit të Komunës për procesin zgjedhor.

1.4. Mandati i Komisionit është i lidhur me mandatin e Kuvendit të Komunës.

Neni 11

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit për zgjedhjen e këshillave lokale

1. Detyrat e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës dhe me këtë Rregullore (në vazhdim të tekstit: Komisioni), përcaktohen, si në vijim:

1.1 kryen përgatitjet e nevojshme dhe veprimet tekniko-administrative për organizimin e zgjedhjeve,

1.2 planifikon dhe kërkon nga organet kompetente të Komunës fillimin e procedurës për furnizim me materiale të nevojshme për organizimin e zgjedhjeve,

1.3 përcakton kohën e mbajtjes së tubimeve zgjedhore të qytetarëve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave,

1.4 harton dhe publikon ftesat për tubimet zgjedhore të qytetarëve,

1.5 cakton nga përbërja e Komisionit, anëtarët për pjesëmarrje në tubimet të qytetarëve,

1.6 siguron shënimet për numrin e qytetarëve me të drejtë vote të lokalitetit,

1.7 përgatitë formularët e certifikatave për kandidatët e zgjedhur anëtarë të Këshillit,

1.8 përgatitë formularët e vendimeve të Tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e Këshillit dhe Kryetarit të Këshillit.

2. Nga tubimet e mbajtura të qytetarëve, siguron kopjet e nënshkruara të procesverbaleve, të certifikatave për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave dhe vendimeve të kryetarëve të këshillave.

3. Komisioni, harton dhe i dërgon Kuvendit të Komunës Raportin për rezultatet e zgjedhjeve, të cilit ia bashkëngjetë kopjet e nënshkruara të procesverbaleve dhe të certifikatave për zgjedhjen e anëtarëve të këshillave dhe të vendimeve për zgjedhjen e kryetarëve të këshillave.

4. Komisioni, bashkë me raportin për rezultatet e zgjedhjeve i dërgon Kuvendit edhe Pasqyrën e materialeve të shpenzuara me koston financiare të furnizimit.

Neni 12

Vendimi për organizimin e zgjedhjeve

Kuvendi i Komunës merr vendim për organizimin e zgjedhjeve për zgjedhjen e këshillave dhe kryetarëve të këshillave të lokalitetit.

Me Vendim përcaktohet vendi dhe data e mbajtjes së tubimeve zgjedhore, numri i anëtarëve të këshillave konform Udhëzimit administrativ duke marrë për bazë edhe numrin e banorëve të lokalitetit si dhe shuma e nevojshme e mjeteve financiare për organizimin e zgjedhjeve.

Neni 13

Përbërja e këshillave lokale

1 Këshillat lokale do të kenë pesë (5) deri në nëntë (9) anëtarë.

1. Këshilli duhet të përfshijë përfaqësimin e çdo fshati, vendbanimi apo lagje urbane, përfshirë përfaqësim gjinor dhe etnik.

Neni 14

Mënyra e zgjedhjes së këshillave lokale

1. Këshilli i lokalitetit zgjedhet në Tubimin zgjedhor të qytetarëve të lokalitetit, në pajtim me Vendimin e Kuvendit të Komunës për organizimin e zgjedhjeve në vendbanime, fshatra dhe lagje urbane
2. Anëtarë të Këshillit, mund të zgjedhen qytetarët me të drejtë vote dhe me vendbanim të përhershëm në lokalitetin për të cilin organizohet zgjedhja e Këshillit dhe Kryetarit të Këshillit.
3. Në Këshill duhet të zgjedhen së paku 30% të anëtarëve nga gjinia femrore.
4. Në lokalitetet, në të cilat jetojnë pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, në përbërje të anëtarëve Këshillit të lokalitetit duhet të jenë të përfaqësuar pjesëtarët e komuniteteve joshumicë.
5. Kandidatët e propozuar zgjedhen anëtarë të Këshillit, të cilët me votim të hapur apo të fshehtë fitojnë numrin më të madh të votave nga shumica e thjeshtë e votuesve në tubimin zgjedhor të qytetarëve.
6. Kryetari i këshillit zgjedhet në mes të anëtarëve të këshillit i cili fiton shumicën e votave të qytetarëve që marrin pjesë në atë tubim. Nëse në rrethin e parë të votimit asnjëri nga kandidatët nuk ka fituar shumicën e votave atëherë organizohet rrethi i dytë i votimit dhe kandidati që merr më shumë vota zgjedhet për kryetar të këshillit me mandat prej 4 viteve.
7. Anëtarë të Këshillit, nuk mund të zgjedhen anëtarët e Kuvendit të Komunës, shërbyesit civil të Administratës së Komunës, anëtarët e Komisionit për zgjedhjet lokale dhe anëtarët e Komisionit për organizimin e zgjedhjeve në vendbanime, fshatra dhe lagje urbane.

Neni 15

Njoftimi për mbajtjen e tubimeve zgjedhore të qytetarëve

1. Komisioni për organizimin e zgjedhjeve, harton dhe publikon Njoftimet për mbajtjen e tubimeve zgjedhore të qytetarëve të vendbanimit, fshatit dhe lagjes së caktuar urbane.
2. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën dhe orën e mbajtjes së Tubimit zgjedhor dhe Rendin e Ditës.

3. Njoftimi do të publikohet në faqen elektronike të Komunës, në tabelën e shpalljeve të Komunës, në vendet më të frekuentuara në vendbanim, fshat apo lagje urbane, së paku 15 ditë para datës së caktuar për mbajtjen e tubimit zgjedhor.

Neni 16

Kuorumi për mbajtjen e Tubimit zgjedhor të qytetarëve

Kuorumin e përbëjnë Tubimi i qytetarëve të cilët marrin pjesë në zgjedhjen e Këshillit të lokalitetit dhe Kryetarit të Këshillit të lokalitetit.

Neni 17

Puna e Tubimit të qytetarëve për zgjedhjen e Këshillit të lokalitetit

1. Punën e Tubimit zgjedhor të qytetarëve e kryeson një qytetar i zgjedhur me shumicë të votave të qytetarëve të Tubimit.
2. Për punën e Tubimit mbahet procesverbali nga një qytetar i Tubimit i caktuar nga shumica e qytetarëve të Tubimit.
3. Pas evidentimit në procesverbal të pranishmëve , në propozim të Kryesuesit, me shumicë të votave Tubimi miraton Rendin e Dites për zgjedhjen e Këshillit dhe Kryetarit të Këshillit.

Neni 18

Evidencimi i kandidatëve dhe mënyra e votimit

1. Pas miratimit të Rendit të ditës, qytetarët propozojnë kandidatët të cilët pranojnë të jenë anëtarë të Këshillit.
2. Votimi për kandidatët e evidencuar mund të bëhet me votim të hapur ose me votim të fshehtë.
3. Për mënyren e votimit, Tubimi vendos me shumicë të votave të qytetarëve prezent.

Neni 19

Procedura e votimit të hapur

1. Konform vendimit për votim të hapur, Kryesuesi, për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, kërkon që të votohet për secilin kandidat të propozuar sipas radhës së evidencimit.

2. Kryesuesi, në bazë të rezultateve të votimit, publikon emrat e kandidatëve të cilët kanë fituar shumicën e votave të qytetarëve prezent dhe janë zgjedhë anëtarë Këshillit.

3. Nëse pas votimit nuk është zgjedhë një numër i anëtarëve të Këshillit, atëherë për zgjedhjen e tyre do të vepohet konform nenit 13 dhe dispozitave të këtij neni.

Neni 20

Procedura e votimit të fshehtë

1. Nëse Tubimi vendos për votim të fshehtë, Kryesuesi, pas evidencimit të kandidatëve në pajtim të nenit 13 të kësaj Rregulloreje i propozon Tubimit emërimin e Këshillit për organizimin e votimit të fshehtë, në përbërje prej tre anëtarëve.

2. Anëtarë të Këshilli për organizimin e votimit të fshehtë, nuk mund të emërohen kandidatët për të cilët duhet të votohet.

3. Këshilli për organizimin e votimit të fshehtë, menjëherë pas emërimit, tërhiqet dhe në vazhdim të punës së tubimit, përgatitë dhe vendosë kutinë për votim dhe i shpërndanë fletëvotimet për votim të fshehtë.

4. Pas votimit, Këshilli për organizimin e votimit të fshehtë, bënë numërimin e votave dhe i komunikon Tubimit Raportin mbi rezultatin e votimit.

5. Raporti mbi rezultatin e votimit të fshehtë duhet të përmbajë:

5.1 konstatimin për numrin e qytetarëve prezent në Tubimin zgjedhor,

5.2 numrin e fletëvotimeve të shpërndara,

5.3 numrin e fletëvotimeve të vendosura në kuti pas votimit,

5.4 numrin e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme dhe

5.5 Emrat dhe mbiemrat e kandidatëve sipas radhës me numrin më të madh të votave të fituara, si dhe të kandidatëve që nuk kanë fituar shumicën e votave të qytetarëve prezent.

5.6 Kryesuesi, konform Raportit të Komisionit, konstaton kandidatët të cilët janë zgjedhë anëtarë Këshillit.

5.7 Nëse pas votimit konstatohet se nuk është zgjedhë një numër i anëtarëve të Këshillit, atëherë për zgjedhjen e tyre të do të veprohet konform nenit 13 dhe dispozitave të këtijë neni.

5.8 Numrimi i votave bëhet në mënyrë publike para pjesëmarrësve në tubimin zgjedhor.

Neni 21

Certifikata dhe Vendimi mbi zgjedhjen

1. Në bazë të rezultateve të votimit për anëtarë të Këshillit, kandidatëve të zgjedhur iu lëshohet Certifikata mbi zgjedhjen anëtarë i Këshillit, e nënshkruar nga Kryesuesi i Tubimit si dhe nga përfaqësuesi i Komisionit i emëruar nga Kuvendi Komunal.

2. Në bazë të rezultateve të votimit për Kryetar të Këshillit, anëtarit të zgjedhur i lëshohet Vendimi mbi zgjedhjen Kryetar i Këshillit i nënshkruar nga Kryesuesi i Tubimi dhe nga përfaqësuesi i Komisionit i emëruar nga Kuvendi Komunal.

Neni 22

Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale

1. Mandati i këshillave lokale është katër (4) vite.
2. Mandati i kryetarit dhe anëtarëve të këshillave lokale përfundon në vijim:
 - 2.1 me kryerjen e mandatit;
 - 2.2 nëse jep dorëheqje;
 - 2.3 nëse shkarkohet;
 - 2.4 nëse ndërron vendbanimin;
 - 2.5 në rast të dënimit për vepër penale me një urdhër për burgim për gjashtë (6) muaj ose më tepër;
 - 2.6 nëse vdes;
3. Procedura e shkarkimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillave bëhet sipas procedurës së përzgjedhjes.
4. Në rast të humbjes së mandatit të kryetarit të këshillit komisioni komunal brenda tridhjetë (30) ditësh duhet të organizoj zgjedhjet për zgjedhjen e kryetarit të ri.
5. Zëvendësimi i anëtarëve të këshillave lokale në rastin e humbjes së mandatit bëhet nga lista e pritjes me aprovimin e komisionit të kuvendit brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh.

Neni 23

Dorëheqja

1. Dorëheqja mund të jepet me shkrim nga anëtari dhe Kryetari i Këshillit, e cila për njoftim i dërgohet Këshillit.
2. Dorëheqja nga funksioni i Kryetarit nuk prezumon edhe dorëheqjen nga funksioni i anëtarit të Këshillit, nëse kjo në dorëheqje nuk është theksuar.
3. Dorëheqja është e plotëfuqishme me datën e specifikuar nga dhënësi i dorëheqjes.

Neni 24

Procedura e shkarkimit

1. Anëtari dhe Kryetari i Këshillit shkarkohet në rastet, si vijon:
 - 1.1 nëse nuk i përmbushë obligimet e përcaktuara me këtë Rregullore,
 - 1.2 Nëse zgjedhet në funksione për të cilat, në pajtim me këtë Rregullore është parapa se nuk mund të jetë anëtarë i Këshillit, nëse për këtë rrethanë anëtari nuk jep dorëheqje.
2. Iniciativën për shkarkim sipas par 1 nënpar. 1.1 të këtijë neni të arsyetuar me shkrim mund ta japin 1/3 % e qytetarëve të vendbanimit, fshatit apo të lagjes urbane.
3. Iniciativën për shkarkim sipas par 1 nënpar. 1.2 të këtijë neni mund ta jap Këshilli apo çdo qytetar në Tubimin e qytetarëve të vendbanimit, fshatit apo të lagjes urbane.
4. Vendimi për shkarkim mund të merret nga Kshilli i Fshatit, Vendbanimit Lagjeve Urbane.

Neni 25

Puna dhe përgjegjësitë e Këshillit të lokalitetit dhe Kryetarit të Këshillit

1. Këshilli i lokalitetit, për rrealizimin e aktiviteteve në përmbushjen e nevojave të qytetarëve, kryen punët dhe është përgjegjës, si vijon
 - 1.1 Thërret Tubimin e qytetarëve për shqyrtimin e çështjeve me interes për plotësimin e nevojave të qytetarëve,

1.2 Inicon dhe njofton Tubimin e qytetarëve dhe organet kompetente të Komunës përkitazi me qështjet e caktuara për zhvillim ekonomik, për organizimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive, për ndërtim të infrastrukturës, për mbrojtje të ambientit, për të rritje të cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve për qytetar si dhe për qështjet tjera me interes për plotësimin e nevojave të qytetarëve,

1.3 Thërret Tubimin e qytetarëve dhe përgatitë vërejtje dhe propozime për shqyrtim publik të Drafteve të akteve nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Komunës,

1.4 Koordinon aktivitetet për zhvillimin e bashkëpunimit me organet e Komunës,

1.5 Inicon qështjet për miratim nga Tubimi i qytetarëve për qështjet e lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me Komunën.

1.6 Ndërmerrë masa për realizimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës me të cilat është vendosë që aktivitetet e caktuara nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Komunës, të kryhen nga vendbanimi, fshati apo lagja përkatëse urbane.

2. Këshilli, për qështjet e cekura në par.1 të këtijë neni vendos në mbledhjet e Këshillit me shumicë të votave të anëtarëve prezent.

3. Për punën e Këshillit mbahet proceverbal.

Neni 26

Puna dhe përgjegjësitë e Kryetarit të Këshillit

Kryetari i Këshillit të lokalitit, kryen punët dhe është përgjegjës, si vijon:

1.1 Thërret dhe i kryeson mbledhjet e Këshillit,

1.2 Njofton Tubimin e qytetarëve dhe organet e Komunës për punën e Këshillit,

1.3 Në pajtim me Vendimin e Tubimit të qytetarëve nënshkruan marrëveshjet për bashkëpunim me Komunën,

1.4 Ndërmerrë masa për zbatimin e Vendimeve të Tubimit të qytetarëve,

1.5 Ndërmerrë masa për zbatimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit me Komunën,

1.6 Ndërmerrë masa për zbatimin e vendimeve të Kuvendit të Komunës me të cilat është vendosë që aktivitetet e caktuara nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Komunës, të kryhen nga vendbanimi, fshati apo lagja përkatëse urbane.

Neni 27
Kompensimi i kryetarëve të këshillave lokale

1. Për punën e tyre kryetarët e këshillave lokale kompensohen nga buxheti i komunës.
2. Kompensimi për kryetarët e këshillave lokale bëhet në shumën ekuivalente të anëtarëve të komiteteve obligative.
3. Kompensimi për pjesëmarrjen në takime bëhet vetëm për gjashtë (6) takime të këshillit lokal të mbajtura brenda vitit kalendarik.

Neni 28
Financimi i aktiviteteve

1. Aktivitetet e këshillave lokale dhe projektet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në mes të komunës dhe këshillave mund të financohen si vijon:

- a. Banorët e fshatit, vendbanimit apo lagjes urbane;
- b. Komuna
- c. Donatorët dhe
- d. Financim të përbashkët

Neni 29
Financimi i zgjedhjeve

Komuna, planifikon dhe siguron mjetet e nevojshme financiare konform Vendimit për zgjedhjet e Këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

IV. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 30
Hyrja në fuqi

1. Kjo Rregullore hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja 15Nr.011-45599 e datës 12.11.2014 si dhe Rregullorja për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkëpunimin e Komunës dhe organizimin e

fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane e datës 15 Nr. 011-23127 e datës 06.05.2015.

Arsyetim

Baza juridike për miratimin e kësaj Rregulloreje është përcaktuar me dispozitat e neneve 12 dhe 34 të Ligjit Nr. 03/ L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 4 par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, si dhe nenit 14 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1 Nr. 110-623 i datës 26.09.2008

Duke u bazuar në dispozitat e sipërcituara, me këtë rregullore në kapituj të veçantë janë rregulluar çështjet:

- bashkëpunimi ndërmjet Komunës me vendbanimet, fshatrat dhe lagjet urbane, iniciativa për lidhjen e marrëveshjeve me format e bashkëpunimit, si dhe procedura e miratimit për lidhjen e marrëveshjeve.
- Organizimi i fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, procedura për zgjedhjen, obligimet dhe përgjegjësitë e këshillave të lokalitetit dhe kryetarëve të këshillave dhe
- Financimi i marrëveshjeve mbi bashkëpunimin, i aktiviteteve nga kompetenca dhe përgjegjësitë e Komunës, financimi i zgjedhjeve të këshillave dhe kryetarëve të këshillave, si dhe financimi i aktiviteteve të caktuara sipas vendimeve në fshatra, vendbanimeve dhe lagjeve urbane.

Ndryshimi i Rregullores bëhet me qëllim të harmonizimit me Udhëzimin e ri administrativ nr. 02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

Nga të cekurat më lartë, kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e kësaj Propozim-Rregulloreje.

1Nr. _____
Lipjan më _____ 2019

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti